



TË DHËNAT PËR ASETIN


Shitja e Aseteve përmes Likuidimit Nr.61

Njësia e Vendosur në Tender Nr.04

Parcelat nr.56-30 dhe 56-41 ZK Dranashiq

Emri i NSh.-së	NPB Malishgani, Klinë në likuidim ("Ndërmarrja") Fi. Fi.265/90
Lloji i shitjes	Shitje përmes Likuidimit me ofertë të mbyllur.
Dita e Ofertimit	Më 07.12.2022 nga ora 10:00h deri 12:00h, në Sallën e Konferencave të "HOTEL GRAND" në Prishtinë.
Regjistrimi i Ofertuesit	Nuk ka para kualifikim
Depozita e Ofertës	5,000 Euro
Vendndodhja e Aseteve	Zona Dranashiq, komuna Klinë, Rajoni Pejë
<u>Përshkrimi i Aseteve</u>	Parcela kadastrale nr. 56-30 me sipërfaqe 462m ² (4ari 62m ²) dhe parcela kadastrale nr. 56-41 me sipërfaqe 8608m ² (86ari 08m ²), te dyja me kulturë pyjor-mal, klasës 3, në ZK Dranashiq, komuna Klinë.
Ndërtesat dhe tokat	Parcela me nr.56-41 nuk ka qasje ne rrugë publike, përderisa parcela me nr. 56-30 ka qasje në rrugë publike me nr. 434. Distanca ajrore në mes të dy parcelave është 235 m. Brenda parcelës nr. 56-30 ekziston një rrugë fushore.
Shfrytëzuesit	Nuk ka
<u>Përshkrimi i Aseteve</u>	Nuk ka.
Asetet tjera	
Detyrimet që do të barten	Asnjë nga detyrimet nuk do të barten tek blerësi i ri, por sidoqoftë blerësi potencial duhet të ketë parasysh se mund të jetë i aplikueshëm tatimi për bartjen e pronës.

Foto/fotot
Ose informata të tjera
Për asetet në shitje



Informatat rreth Njësisë lëndë e shitjes të prezentuar në Te Dhëna nuk janë të garantuara. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilët dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: <http://www.pak-ks.org>.

RAPORT I VIZITËS NË TERREN

NPB Malishgan, Parcelat nr.56-30 dhe 56-41 z.k Dranashiq, Klinë

Me datë 09.06.2022 zyrtarët e AKP-së vizituan pronën e NPB Malishgan, konkretisht parcelat me nr. 56-30 dhe 56-41 z.k Dranashiq, Klinë.

Parcelat sipas certifikatës së pronësisë evidentohen në emër të NPB Malishgan.
Sipërfaqja e përgjithshme e parcelave është prej 9070 m² (90 ari dhe 70m²) prej të cilave :

Parcela nr. 56-30 ka sipërfaqe prej 462 m² me kulturë: pyjor , mal i klasës 3;

Parcela nr. 56-41 ka sipërfaqe prej 8608 m² me kulturë pyjor , mal i klasës 3.



Ortofoto e parcelave nr.56-30 dhe 56-41 z.k Dranashiq, Klinë.

Nga vizita jonë në terren konstatuam se :

1. Për shkak të kushteve të vështira të terrenit , vrojtimi i parcelës nr.56-41 është bërë nga distanca sepse qasja në parcelë ishte e pamundur.
Për shkak se shumica e parcelave janë me kulturë pyjor-mal atëherë e vetmja mënyrë e raportimit mbi gjendjen faktike të tyre janë ortofotat dhe imazhet satelitore.

Raportimi është bërë nga analizat e bëra në ortofoto dhe kopje të planit.

2. Nga kopjet e planit konstatohet se parcela nr.56-41 nuk ka qasje në rrugë publike, përderisa parcela nr.56-30 ka qasje në rrugën publike (parcela nr.434).
3. Në parcelën nr.56-30 ekziston rrugë fushore.
4. Distanca ajrore mes të dy parcelave është 235m.

Fotografia e mëposhtme e realizuar nga largësia prezanton gjendjen e parcelave në z.k Dranashiq:



Pamje e parcelës nr.56-30 dhe pamje nga largësia e parcelës nr.56-41 z.k Dranashiq

D.Gojani-Zyrtar Kadastral Rajonal

L.Agushi- Zyrtar e Operacioneve për Administrim të Aseteve

AKP- ZR PEJË/Qershar 2022

Informatat

Departamenti i Marketingut, Marrëdhënieve me Publikun dhe Investitorët

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +381 (0) 38 500 400 ext 1090, 2059

Fax: +381 (0) 38 248 076

www.pak-ks.org

Dokumentet e Ofertimit

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Rruga: Dritan Hoxha, nr.55

10000 Prishtinë, Republika e Kosovës